



Duke u bazuar ne dispozitat e nenit 12 dhe 40 paragrafi 40.2 nen b), si dhe nenin 17 nen f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 publikuar ne Gazetën Zyrtare nr.28/2008, dispozitat e nenit 15, 16 te Ligjit për Investime Strategjike ne Republikën e Kosovës, nr.05/L-079, dispozitat e nenit 4 te Ligjit për Shpronësimin e Pronës se Paluajtshme, nr.03/L-139, si dhe dispozitat e nenit 40 nën b) te Statutit te Komunës se Klinës te vitit 2010, me kërkesën e Drejtorisë se Shërbimeve Publike dhe Kryetarit të Komunës 01Nr.06-31877/2019 të dt.29.07.2019, Kuvendi i Komunës se Klinës ne seancën e vete te rregullt te mbajtur me datën 26.07.2019, mori këtë,

V E N D I M

Për përcaktimin e projektit me interes te përgjithshëm- strategjik, ndërtimin e liqenit artificial për furnizim me uji të pijshëm për Komunën e Klinës

- I. MIRATOHET, projekti me investim strategjik “Ndërtimi i Liqenit Akumulues për Furnizim me uji të Pijshëm” për komunën e Klinës, në ngastrat kadastrale sipas vendimit nr.01-465-43 të datës 12.04.1989.
- II. Projekti, “Ndërtimi i Liqenit Akumulues” ka për qellim zgjidhjen e problemit me furnizim të ujit të pijshëm për 54 fshatrat e Komunës së Klinës si dhe lagjet urbane të qytetit, realizimi i të cilit projekt është më rendësi jetike për qytetaret e Komunës së Klinës.
- III. Kompetent për implementim të këtij vendimi është organi Ekzekutiv i Komunës së Klinës.
- IV. Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL në bazë të nenit 81 të LVL dhe nenit 16 dhe 17 të Rregullores së MAPL Nr.01/2017.
- V. Me këtë vendim të njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria Komunale e Shërbimeve Publike dhe Emergjente, Zyra Ligjore, Shërbimi për punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-32347 /2019
Klinë, me 31.07 /2019



KRYESUESI,
Fadil Gashi